



Raporti i Ndërmarrjes N.P.L Dardana SH.A

Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" SH.A ka filluar të konsolidohet nga fundi i vitit të kaluar, më konkretisht më 30.11.2023, kur kuvendi komunal mori vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "Dardana" Sh.A Kamenicë, me këtë përbërje: një anëtar nga ekzekutivi dhe dy asambleistë nga kuvendi komunal i Kamenicës. Takimi i parë i aksionarëve është mbajtur më 15 janar 2024, ku është votuar për kryesuesin e aksionarëve dhe aprovimin e statutit, pastaj është aprovuar statuti i ndërmarrjes dhe më 16 janar është nxjerrë vendimi për 4 anëtarët e bordit të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes "Dardana" Sh.A. Komuna është pronare e ndërmarrjes dhe vlera themeltare e saj është 10 mijë euro.

Pas përzgjedhjes së bordit, bordi ka filluar procedurat për konsolidimin e ndërmarrjes, ku ka shpallur konkurse për kryeshef të ndërmarrjes, sekretar dhe zyrtar financiar. Pas rekrutimeve, bordi i drejtorëve ka përzgjedhur kryeshefin me mandat 6-mujor dhe zyrtarin financiar me kontratë pune prej 3 vitesh. Ndërsa për sekretar, konkursi është anuluar disa herë për shkak të mungesës së aplikantëve adekuat për këtë pozitë. Poashtu gjatë kësaj periudhe janë punësuar edhe 4 puntor, një kryepunëtor dhe tre punëtor teknik.

Pas përfundimit të mandatit të bordit të përkohshëm dhe kryeshefit për 6 muaj, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka shpallur konkurs për bordin e drejtorëve me kontratë prej 3 vitesh. Tani bordi është funksional dhe përbëhet nga katër anëtarë: dy burra dhe dy gra, ku tre prej tyre janë nga diaspora.

Aktivitetet me të cilat ka filluar ndërmarrja, që janë të përfshira edhe në statutin e saj në nenin 7, janë:

0119 - Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare

0129 - Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare

4321 - Instalime elektrike

4322 - Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit

7712 - Marrja dhe dhënia me qira e kamionëve

8122 - Aktivitete të tjera të pastrimit të ndërtesave, objekteve industriale

8129 - Aktivitetet e tjera të pastrimit – largimi i deponive ilegale: inerte dhe të tjera

8130 - Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të mjedisit (rrugë lokale, trotuare, parqe, sheshe, varreza, ndriçim, sinjalizim etj.)

Aktivitetet e tjera që janë shtuar gjatë rrugëtimit për shkak të projekteve të reja janë:

9329 - Aktivitete të tjera të argëtimit dhe rekreacionit

0170 - Gjuetia, vendosja e pusive dhe aktivitetet e tjera shërbyese

5221 - Aktivitete shërbyese të rastit për transportin tokësor

5229 - Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit

Për të gjitha konkurset, njoftimet dhe aktivitetet e tjera ky është linku i faqes zyrtare në rrjetin social Facebook:

<https://www.facebook.com/profile.php?id=61555365699289>

Deri me tani janë arritur disa marveshje në mes të NPL Dardana dhe Komunës së Kamenicës, pastaj kan filluar edhe punimet në terren.

Me poshtë janë detajet e dy muajve punë. Kostoja per muajin Gusht 10,851.00 euro, ndërsa për muajin shtator 10,258.42 euro.

Raporti punës për muajin Gusht 2024

Java e parë:

Mirëmbajtja e sheshit, kositja e barit në hapësirat e qytetit, si dhe mirëmbajtja e parqeve në qytet, më konkretisht parku përballë komunës (fusha e basketbollit në park), ku rrethojat janë të mbuluara nga shkurret. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra publike, pastrimi i pllakave (dysHEMEJA), largimi i degëve të drunjve që herë pas here shkëputen dhe bien në rrugë, si dhe kositja e barit dhe largimi i tij. Mirëmbajtja e përmendores Isa Kastrati.

Rruga Skënderbeu: mirëmbajtja, kositja e barit dhe largimi i tij. Pastrimi i hapësirave të gjelbra tek drejtorja e financave, kositja e barit tek ish-hoteli Mineral. Mirëmbajtja e hapësirave tek busti i dëshmorit Besnik Maroca. Mirëmbajtja e hapësirave para Hidro Morava, tek shtëpia e kulturës dhe parqet në të dy anët e rrugës. Mirëmbajtja e parkut në afërsi të shtëpisë së Kulturës Isa Kastrati, duke përfshirë hapësirat gjelbëruese dhe pllakat.

Rruga Vëllezërit Bytyqi, duke filluar nga bulevardi i qytetit deri tek rrethi: pastrim, kositje dhe pastrim i shportave.








Java e dytë:

Mirëmbajtja e sheshit të qytetit, si zakonisht për shkak të fluksit të madh të njerëzve në qytet, përfshin mbledhjen e mbeturinave, pastrimin e shportave, si dhe kositjen e barit në pjesë të caktuara të qytetit. Po ashtu, kositja e barit dhe largimi i shkurreve te Stacioni i Autobusëve.


Gjithashtu, me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, është bërë pastrimi i varrezave të Berivojcës dhe i parkut te xhamia në Berivojcë, së bashku me pjesët përcjellëse.

Mirëmbajtja e hapësirave përballë tregut, në të dy anët e rrugës, afër lagjes Malësia. Mirëmbajtja e përmendores së dëshmorëve te tregu i gjelbër, përfshirë kositjen e barit dhe largimin e mbeturinave. Mirëmbajtja e parkut të qytetit përballë qendrës tregtare.














Java e tretë:


Mirëmbajtja e hapësirave në qytet, si zakonisht, përfshin kositjen dhe mbledhjen e mbeturinave në pjesët e sheshit dhe pastrimin e shportave. Mirëmbajtja e rrethit në qendër dhe e parkut të Qendra për Punë Sociale. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra rreth objektit të komunës, përfshirë pastrimin e kubëzave, kositjen e barit dhe kujdesin për drunjtë dekorativë.

Me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, është kryer edhe pastrimi i varrezave në lagjen Malësia deri në përfundim.









Java e katërt:

Kositja e barit në shesh dhe mirëmbajtja e hapësirave rreth sheshit me parqe, pastrimi i komplet zhavorrit dhe barit nga lagjja Konaku deri te shkolla "Ismail Qemali". Larja e pllakave në sheshin "Metush Krasniqi", si dhe, me kërkesë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, është bërë pastrimi i lapidarit të dëshmorëve të kombit në fshatin Gjyrishefc.

Mirëmbajtja e hapësirave te çerdhja e fëmijëve, kositja e barit, largimi dhe pastrimi i vendit. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra skaj rrugës "Tahir Sinani", nga parku i qytetit deri te zjarrfikësit. Mirëmbajtja e hapësirës te komuna e vjetër, nga rruga "Nëna Terezë" deri te palestra sportive.







Raporti i punës për muajin shtator 2024


Java e parë e muajit shtator ka vazhduar me mirëmbajtjen e hapësirave publike në qytet, duke përfshirë kositjen e parqeve dhe mbledhjen e mbeturinave në pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe largimin e zhavorrit në rrugën "Nëna Terezë", "Muharrem Kastrati" dhe lokacione të tjera.



Java e dytë e muajit shtator ka vazhduar sërish me mirëmbajtjen e pjesëve të brendshme të qytetit, përfshirë parqet dhe rrugët e qytetit. Aktivitetet përfshijnë zbrazjen e shportave sipas planit, largimin e deponive ilegale dhe kositjen e hapësirave të gjelbra.



Java e tretë ka vazhduar me punë intensive në sheshin e qytetit dhe hapsirave tjera mbrenda hapësirës urbane.



Java e katërt ka vazhduar me kryerjen e punëve me kerkesë të DSHPAI

Varrezat në Lagjen Qameria





Pastrimi i rrugës "Ilir Konushefci" dhe "Celulat e UÇK-së" ka përfshirë kositjen e barit, largimin e zhavorrit nga trotuari, si dhe krasitjen e degëve në të dy anët e rrugës.





Pastrimi i varrezave të komunitetit serb në Kamenicë ka përfshirë kositjen e barit, krasitjen dhe largimin e drunjve dhe shkurreve në hapësirën e brendshme të varrezave.



Pastrimi i rrugëve "Dëshmorët e Kombit", "Beteja e Kikës" dhe "Shpend Dragobia" ka përfunduar me sukses. Aktivitetet kanë përfshirë mbledhjen e mbeturinave, kositjen e barit dhe mirëmbajtjen e përgjithshme të këtyre rrugëve.



Edon Dermaku, kryesues i aksionarëve